

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË** – Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarve J.U., E.M., G.H.dhe B.Sh., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.87Ç/13 të dt.05.10.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën për hudhjen e aktakuzës, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor, më dt.19.10.2018, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Kundër të akuzuarit B.Sh., i biri i Sh. dhe F., i vajzërisë K., i lindur me ..., në P, tani me vendbanim në S., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i ... fëmije, i nacionalitetit ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës dhe Suedisë.

për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga akuza, Konform nenit 363 par.1 pika 1.1. të KPPRK-së,

**REFUZOHET AKUZA**

Sepse

Me dt.12.12.2010, në qendrën e votimit me numër 1923E/01R, në shkollën e mesme ekonomike ‘‘H.K.’’, në P., në lagjen ‘‘D.’’, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të pandehurit A.J., J.U., B.Gj., M.K., E.M., G.H. dhe B.Sh., në bashkëkryerje, me qëllim të ndryshimit të rezultateve të zgjedhjes, kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve, në atë mënyrë që u kanë hequr votat disa kandidatëve dhe u kanë shtuar kandidatëve tjerë, duke i regjistruar në mënyrë jo të saktë 598 (pesëqindënëntëdhjetëtetë) vota, dhe atë nga kandidatët e subjektit politik FER 71 (shtatëdhjetenjë) vota, AKR 57 (pesëdhjetë e shtatë) vota, LDK 198 (njëqind e nëntëdhjet e tetë) vota, VV 152 (njëqind e pesëdhjet e dy) vota, AAK 21 (njëzetënjë) vota dhe PDK 98 (nëntëdhjetëtetë) vota,

-me këtë kishte për të kryer veprën penale Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate, konform nenit 454 par.1 të KPPRK-ës.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë, PP.I.nr.87Ç/13 të dt.05.10.2017, kundër të akuzuarve A.J., B.Gj., M.K., E.M., G.H. dhe B.Sh. për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar të kryerjes së veprës penale në bashkëkryerje Mashtrimi në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Meqenëse gjykata në seancën e parë të shqyrtimit fillestar nuk ka mund ta sigurojë praninë e të gjithë të akuzuarve për shkak se një pjesë e tyre janë me vend qëndrim a vendbanim jashtë Kosovës, fillimisht J.U., E.M., G.H.dhe B.Sh. ka veçuar dhepezulluar procedurën dhe ka lëshuar urdhërarrest kundër katër të

akuzuarve, derisa ka vazhduar procedurën penale kundër tre të akuzuarve A.J., B.Gj., M.K. dhe ka vendosur lidhur me këtë çështje penale.

Në ndërkohë policia e Kosovës duke vepruar sipas urdhërarrestit të kësaj gjykate e ka ndaluar, arrestuar dhe dërguar në Qendrën e Paraburgimit me dt.16.09.2018 tani të akuzuarin B.Sh. dhe ditën e nesërme, pra me dt.17.09.2019 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar dhe gjatë kësaj seance prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza, në mungesë të provave.

Andaj bazuar në një gjendje të tillë të fakteve, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës kundër të akuzuarit B.Sh., konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale është marrë, duke pas për bazë faktin se kundër të akuzuarit është refuzuar akuza, konform nenit 454 par.1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 par.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.178/18, dt.19.10.2018**

**Bashkëpunëtor profesional**  
Driton Berisha

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.